

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-218/11

Prishtinë, 24 gusht 2012

Në çështjen juridike të

S.(H.)R.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kundër

L.N.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/44/2009 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00258), të datës 11 qershor 2009, pas shqyrtimit të mbajtur me 24 gusht 2012, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si a pabazuar ankesa e S.(H.)R..
- 2- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/44/2009, i datës 11 qershor 2009, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA00258.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 530 (pesëqind e tridhjetë euro) në buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 16 janar 2007, L.N. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar ri-posedimin e pronës së tij. Paraqitësi i kërkesë pohon se prona e paluajtshme ishte humbur si rezultat i rrethanave të vitit 98/99 në Kosovë dhe thekson se data e humbjes është 15 qershor 1999. Ai ka pohuar se është bashkëpronar i një ngastre që ndodhet në Komunën e Prishtinës, në Llojza e Vjetër, Sofali, me numër të fletës poseduese 155, zona kadastrale e Sofalisë, ngastra numër 691, me sipërfaqe prej 0 ha, 9 ari e 89 m² dhe ka deklaruar se ajo ishte e uzurpuar.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai i kishte ofruar AKP-së dokumentet vijuese:

- Kontratën e nënshkruar të shitblerjes të datës 20 qershor 1988, që e identifikon atë si bashkë-blerës të pronës;
- Fletën poseduese nr. 155, të lëshuar me datë 14 prill 1995, Zyra Republikane e Gjeodezisë, Shërbimi për Kadastër i palujtshmërive, komuna kadastrale e Sofalisë, Republika e Serbisë, që konstaton se L.N. ishte bashkëpronar i ngastrës së kërkuar;
- Fletën poseduese nr. 155, të datës 22 qershor 2004, nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, zona kadastrale e Soflisë, që tregon se ngastra e kërkuar ishte regjistruar në emër të L.N. si bashkëpronar;

- Kopjen e planit nga Komuna e Prishtinës, komuna kadastrale e Sofalisë , të datës 22 qershor 2004, me të cilën vërtetohet se L.N. është bashkëpronar i ½ së pronës së kërkuar - ngastrës kadastrale nr. 691.

Me 13 mars 2008, ekipi për njoftim i AKP-së ka shkuar në vendin ku supozohej se ndodhej ngastra e kërkuar dhe ka vendosur një shenjë që tregtonte se prona ishte objekt i kërkesës dhe se palët e interesuara është dashur të paraqesin përgjigjen e tyre brenda 30 ditëve. Prona është gjetur e uzurpuar nga S.R. (pala përgjegjëse në kërkesë) i cili ka qenë prezent në pronë dhe ka pretenduar të drejtën ligjore ndaj pronës. Ekipi për njoftim i AKP-së e ka ri-vizituar ngastrën e kërkuar pronësore nr. 691 me 3 shkurt 2010 dhe ka konfirmuar se njoftimi i pronës është bërë në bazë ortofotos dhe koordinatave të GPS-it.

Fleta poseduese nr. 155 ishte verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.

Me 11 qershor 2009, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/A/44/2009 ka gjetur se paraqitësi i kërkesës e kishte vërtetuar bashkë-pronësinë për pronën pronës, pasi që paraqitësi i kërkesës kishte paraqitur një fletë poseduese dhe një kontratë të të lidhur të shitblerjes dhe është urdhëruar pala përgjegjëse në kërkesë që të liroj pronën e kërkuar në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit dhe se në të kundërtën i njëjti do të dëbohet nga ajo pronë.

Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë me 14 nëntor 2011. Me 2 dhjetor 2011, pala përgjegjëse në kërkesë (këtej e tutje: pala ankuese) ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke e kundërshtuar vendimin e KKPK-së, mbi bazën zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të së fakteve.

Pala ankuese ka deklaruar se ai është pronar i ngastrave të ndryshme nr. 705/1, nr. 705/3, nr. 706/1, nr. 707/1 në vendin e quajtur “Strana e nalte” sipas Vendimit mbi Trashëgiminë T.nr.50/2001 dhe pronar i ngastrave nr. 692/1 dhe 693 që gjenden në vendin e quajtur “ish Velika Strana”, komuna kadastrale e Sofalisë, fleta poseduese nr. 76. Pala ankuese nuk ka paraqitur ndonjë nga provat e përmendura..

Ankesa i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (këtej e tutje: pala përgjegjëse në ankesë me 8 dhjetor 2011. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka reaguar.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKKPK-së është i drejtë. Gjykata nuk gjen as vërtetimin jo të plotë të fakteve e as zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.

Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Pasi që paraqitësi i kërkesës cek se data e humbjes është qershori i vitit 1999, kërkesa ka të bëjë me rrethanat që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë.

Gjykata Supreme pajtohet me AKP-në se pala përgjegjëse në kërkesë/pala ankuese, i cili aktualisht ka uzurpuar pronën, përderisa pretendon të drejtën e tij ligjor ndaj pronës, nuk ka paraqitur dokumentacion apo ndonjë informacion tjetër në mbështetje të një asaj të drejte as në kohën e njoftimit të pronës e as në ankesë, përkundër faktit se atij i është dhënë mundësia për ta bërë këtë. Në ankesë, pala ankuese deklaron se është pronar i disa ngastrave nr. 705/1, nr. 705/3, nr. 706/1, nr. 707/1 në vendin e quajtur “Strana e nalte” dhe pronar i ngastrave nr. 692/1 dhe 693 që gjenden në vendin e quajtur “ish Velika Strana”, komuna kadastrale e Sofalisë, me numra të ndryshëm nga ngastra e kërkuar nga pala përgjegjëse në ankesë. Kështu që, këto ngastra nuk kanë të bëjnë asgjë me vetë kërkesën, e cila i referohet ngastrës nr. 691. Pala ankuese i referohet një flete poseduese me numër 76 të cilën ai nuk e ka paraqitur dhe e cila po ashtu është me numër të ndryshëm krahasuar me fletën poseduese nr. 155 që është relevante për kërkesën (KPA00258) pranë KKKPK-së.

Nga faktet e lartpërmendura rezulton se gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se konfirmimi i vendimit të KKKPK-së nuk është sjellë në dyshim nga asnjë provë e vlefshme.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit.

Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet të jetë mbi 90.000 €: 500 € (50 € + 0,5% e 90.000 € por jo më shumë se 500 €).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 45 Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, taksat nga tarifa gjyqësore duhet të paguhen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Neni 47.3 parasheh se në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së tarifës. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Philip Drake, Shef i Shkrimores pranë Asemblesë së Gjyqtarëve të EULEX